

PROGRAMI PËR RIMËKËMBJEN E RRËQEBULLIT TË BALLKANIT

Newsletter

ÇËSHTJET KRYESORE

- Fq. 1 - Ribashkimi për ruajtjen e rrëqebullit
- Fq. 2 - Dokumentari për qentë endacakë
- Fq. 3 - Monitorimi me kamera kurth dhe mbledhja e kampioneve jo invazive në zemër të zonës së përhapjes së Rrëqebullit të Ballkanit
- Fq. 4 - Studimi mbi Dimensionin Human 2023 është duke u realizuar në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe Kosovë
- Fq. 5 - BLRP feston ditën e rrëqebullit
- Fq. 6 - Njohuritë teknike mbi Mishëngrënësit e mëdhenj në Slloveni të prezantuara përpara palëve të interesit në Maqedoni
- Fq. 7 - Propozim për përfshirjen e Rrëqebullit Euroaziatik dhe Rrëqebullit të Ballkanit në shtojcat e Konventës për Llojet Migratore (CMS)



© LL/BLRP

RIBASHKIMI PËR RUAJTJEN E RRËQEBULLIT

Nga Lisa Leschinski

Ekipi i BLRP (Programi i Rimëkëmbjes së Rrëqebullit të Ballkanit) është mbledhur së fundmi në Pejë, Kosovë, nga data 19-22 Qershor, për takimin mes partnerëve. Ky takim ishte me rëndësi për projektin ndërkuftar, duke i dhënë mundësinë pjestarëve të ekipit që të kalojnë më tepër kohë sëbashku dhe për të diskutuar mbi projektin. Ky takim mirëpritur dhe pjesëtarë të rinj, duke pasuruar akoma më tej përpjekjet e përbashkëta. Këtë vit janë krijuar dy grupe të reja pune, grupi i punës i komunikimit dhe ai i politikave. Dita e parë e takimit iu dedikua këtyre tematikave, për të cilat u prezantua progresi i punës për strategjinë e komunikimit nga Ksenija Putilin ndërsa Bruna Campos realizoi një prezantim informues mbi tematikën e advokimit.

Dita e dytë ofroi një vizitë emocionuese në terren në Parkun Kombëtar magjepsës “Bjeshkët e Nemuna”. Partnerët e ERA-s, udhëhoqën ekipin e BLRP-së përgjatë parkut, aty ku patën privilegjin të shijonin paisazhet mahnitëse, të cilat janë shtëpia e të paktën njërit prej individëve të mbetur të rrëqebullit të Ballkanit.

Si rezultat i përgjithshëm, takimi ishte shumë frytdhënës. Grupi i punës së komunikimit u socializuan më shumë me njëri-tjetrin duke nxitur bashkëpunimin dhe sinergjinë brenda ekipit. Për më tepër, në ditën e tretë u realizua një vlerësim gjithëpërfshirës i aktiviteteve aktuale dhe objektivave për vitin e ardhshëm. Kjo mbledhje i mundësoi të gjithë anëtarëve të ekipit të njihen më shumë me njëri-tjetrin dhe të forcojnë angazhimin e tyre drejt vizionit të përbashkët të projektit.



Fotografi gjatë takimit me partnerët e BLRP, në Qershor 2023

DOKUMENTARI PËR QENTË ENDACAKË

Nga Dime Melovski

Për shkak të fluksit të vazhduar të shtimit të rasteve të qenve endacakë në Maqedoninë e Veriut, ky problem është duke u bërë edhe më domethënës për jetën e egër në përgjithësi dhe rrëqebullin e Ballkanit në veçanti. Ne kemi identifikuar tre procese të ndryshme se si qentë endacakë mund të dëmtojnë jetën e egër: 1) Disa qen endacakë krijojnë kope të cilët gjuajnë njëhundra dhe pre të tjera të vogla, duke shtuar presion tek fauna vendase ; 2) qentë endacakë ushqehen me kërmat e presë së mishëngrënësve të tjerë. Ne evidentuam disa herë se si një pre e rrëqebullit të Ballkanit është duke u përfunduar nga qentë endacakë; 3) Qentë e gjinisë femërore mund të shumohen me ujçërit meshkuj duke çuar në hibridizim që mund të ndryshojë pamjen natyrale dhe sjelljen e ujçërve. Për të theksuar këtë problem dhe për të rritur ndërgjegjshimin e politikanëve dhe publikut maqedonas, ne kemi realizuar një dokumentar të quajtur “Wilderness”, i përbërë nga 3 episode. Ky dokumentar u realizua në bashkëpunim me Institutin e Studimeve të Komunikimit.

Episodi i parë, “Danger for the lynx”, tregon se si ka nisur ky problem dhe cilat mund të jenë zgjidhjet e mundshme:

<https://www.youtube.com/watch?v=fpzD6Y0II4k&t=1s>

Episodi i dytë: “Clash of laws”, kërkon të gjejë zgjidhje në vendet e tjera të BE-së. Një intervistë me një studiuese nga Rumania, Teodora Sin, tregon si rumunët janë duke u përballur me këtë situatë dhe çfarë ndryshimesh janë të nevojshme në aspektin ligjorë për të nisur me zgjidhjen e problemit:

<https://www.youtube.com/watch?v=OSQzec0rpUQ>

Episodi i tretë: “Human Responsibility” është më shumë i fokusuar në llojin hibrid qen-ujk. Intervista me kryetarin e Iniciativës së Mishngrënësve të Mëdhenj për Evropën dhe ekspertin kryesor të ujçërve, Luigi Boitani, i kushtohet këtij fenomeni dhe rolit që luajnë ujçërit në ekosistem, por edhe përmasave që ky problem arriti në Itali dhe në histori dhe gjithashtu hendekut në rritje midis studiuesve dhe organizatave të mirëqenies së kafshëve

https://www.youtube.com/watch?v=T_0vFds9o4E

MONITORIMI ME KAMERA KURTH DHE Mbledhja E KAMPIONEVE JO INVAZIVE NË ZEMËR TË ZONËS SË PËRHAPJES SË RRËQEBULLIT TË BALLKANIT

Nga Dime Melovski; Melitjan Nezaj dhe Ilir Shyti

Një nga aktivitetet më të rëndësishme në kuadër të Programit për Rimëkëmbjen e Rrëqebullit të Ballkanit ka qenë monitorimi i rregullt dhe sesionet sistematike me kamera kurth të organizuara në zonën qendrore të përhapjes së rrëqebullit të Ballkanit – Parkun Kombëtar të Mavrovës. Pas zhgënjimit gjatë sezonit të fundit monitorues intensiv në 2021, ku arritëm të fotografonim vetëm katër individë të ndryshëm, dhe sesionit jo sistematik premtues të vitit të kaluar, ky sesion monitorimi ishte vendimtar për të treguar se cilët individë të rrëqebullit janë ende të pranishëm në zonë dhe për të provuar të përcaktojmë dendësinë në brendësi të parkut dhe përreth. Këtë vit ne synuam 40 vendndodhje në vend të 30 që ne monitorojmë zakonisht në Mavrovë në mënyrë që të rrisim mundësitë për të fotografuar individë të rinj dhe për të pasur më shumë rifotografime për një analizë më të mirë statistikore.

Të gjitha vendodhjet u mbuluan me nga dy kamera të vendosura përballë njëra-tjetrës, me synimin për të pasur më shumë imazhe cilësore, dhe identifikimin e saktë të individëve. Kamerat kurth ishin të vendosura nga mesi i muajit shkurt deri në gjysmën e dytë të prillit, duke siguruar që secila kamerë të operohej për të paktën 60 ditë. Rezultatet treguan tetë individë të ndryshëm të fotografuar në 13 nga 40 sitet e parkut. Rrëqebujt rezidentë B39, B30, B41 dhe B25 enden akoma nëpër park, së bashku me Atidzhen, të cilën e hasëm për herë të parë para dhjetë vitesh dhe e pajisëm me qafore me GPS në 2020-ën. Lisa dhe Narcisa, femrat fqinje, gjithashtu të pajisura me GPS në 2020-ën, nuk u shfaqën në kamerat tona këtë vit. Paralelisht me monitorimin me kamera kurth, MES realizoi gjithashtu një studim për vlerësimin e dendësisë së lepurit të egër në katër zona të ndryshme në Mavrovë. Marie Busschots, praktikantja jonë nga Belgjika ishte përgjegjëse për realizimin e plotë të këtij studimi; konceptimin, punën në terren, analizën dhe raportimin. Ne përzgjedhëm si livadhet e braktisura ashtu edhe ato të përdorura në afërsi të fshatrave ku ushqehen lepujt.

Rezultatet ishin të kënaqshme, duke vlerësuar gati nëntë lepuj për kilometër katror, pra ushqim të bollshëm për rrëqebullin e Ballkanit.

Më në fund, ne bëmë një grumbullim dhjetëditor jo-invasiv të mostrave të rrëqebullit për monitorimin e ardhshëm gjenetik. Për këtë qëllim ftuam dy kolege nga Sllovenia, Ursa Flezar dhe Teresa Oliviera, të cilat punojnë për projektin Dinaric lynx LIFE Lynx. Qeni i stërvitur i Ursës, Ruby, ishte kyç në gjetjen e disa shenjave të rrëqebullit: jashtëqitje, mbetje ushqimi dhe qime rrëqebulli përgjatë transekteve të përcaktuara dhe tre kafshë të vrara prej tij. Materiali do të dërgohet në Lubjanë për analiza të mëtejshme gjenetike. Si gjithmonë, e gjithë puna në terren është mbështetur nga stafi i Parkut të Mavrovës, duke ofruar ndihmë në logjistikë dhe nëpërmjet shërbimit të rojeve mjedisore. Vullnetarët, praktikantët dhe kolegët nga jashtë vendit, e bënë sesionin e monitorimit më të lehtë dhe argëtues.

Në Shqipëri, studimi i monitorimit intensiv me kamera kurth u zhvillua gjithashtu me vendosje paralele të dy kamerave në 30 vendndodhje (29 grida), shumica prej të cilave në brendësi të Parkut Natyror të Munellës. PPNEA realizoi monitorimin në bashkëpunim me administratat rajonale të zonave të mbrojtura, duke filluar nga dhjetori 2022 deri në Maj 2023. Sezoni i monitorimit rezultoi në fotografimin e dy individëve të rrëqebullit të Ballkanit. Një total prej 89 fotografish të rrëqebullit u realizuan në 12 vendodhje. Nga analiza paraprake e të dhënave, u vu re edhe prania e bollshme e preut të rrëqebullit, kryesisht e kaprollit, lepurit të egër dhe dhelprës. Mishngrënës të tjerë si ariu i murrmë, ujku dhe çakalli ishin gjithashtu të pranishëm në biokorridoret e përdorura nga rrëqebulli.

Në të njëjtën kohë me studimin me kamera kurth, u realizua edhe mbledhja e materialit gjenetik. Në total, grupi i monitorimit mbledhi 14 kampione gjenetike (13 jashtëqitje dhe një kampion i preut të vlarë). Materiali i grumbulluar po ruhet në kushtet e përshtatshme për t'u dërguar më vonë për analiza të mëtejshme.

STUDIMI MBI DIMENSIONIN HUMAN 2023 ËSHTË DUKE U REALIZUAR NË SHQIPËRI, MAQEDONINË E VERIUT DHE KOSOVË

Nga Aleksander Trajçe dhe Bledi Hoxha



"Studimi i parë mbi Dimensionin Human është realizuar në 2007-2009 në zonat malore të Shqipërisë dhe Maqedoninë e Veriut, në kuadër të nisjes së Programit për Rimëkëmbjen e Rrëqebullit të Ballkanit. Duke u bazuar në opinionin e banorëve të zonës u morën të dhëna nëpërmjet pyetësorëve lidhur me sjelljen e mishëngrënësve të mëdhenj, praninë, përhapjen, dëmet e shkaktuara, dhe menaxhimin, në komunat dhe bashkitë të gjendura brenda rajoneve ku hasen mishëngrënësit e mëdhenj. Këto të dhëna ishin thelbësore për të përcaktuar zonat me rëndësi të lartë për praninë e rrëqebullit të Ballkanit, presë së tij, dhe mishëngrënës të tjerë të mëdhenj si ujku dhe ariu, ashtu si edhe konceptimin e objektivave në parandalimin e rreziqeve dhe rimëkëmbjes së popullatës së rrëqebullit në gadishullin e Ballkanit.

Studimi i dytë mbi Dimensionin Human është duke u realizuar përgjatë vitit 2023, duke përfshirë Kosovën, atje ku ky studim është duke u realizuar për herë të parë. Ky anketim është zhvilluar pas studimeve kërkimore të ngjashme mbi dimensionin human në shtete të tjera të Evropës. Draft-Plani i parë i anketimit u përgatit në fillim të vitit 2023 nga Aleksandër Trajçe, ekspert për Dimensionin Human të Mishëngrënësve të mëdhenj pranë PPNEA-s, dhe u finalizua pas komenteve të marra nga sesionet e trajnimeve të organizuara në 23-24 Shkurt në Tiranë. 18 vullnetarë e studentë si dhe 4 anëtarë nga Programi i Rimëkëmbjes së Rrëqebullit të Ballkanit nga tre shtete u trajnuan për të zbatuar pyetsorin në terren.



Pyetjet janë organizuar rreth njohurive të përgjithshme si perceptimet, besimi, njohuri mbi llojet, menaxhimin, përvojat personale dhe informacione sociodemografike. Gjithashtu, në këtë pyetësor u përfshinë edhe pyetje specifike lidhur me përforsimin e popullatës. Perceptimet dhe vlerat bazohen në një shkallë pëlqimi me vlerësim prej 5 pikësh dhe rënditen nga 1 (nuk pajtohem/nuk më pëlqen) deri në 5 (plotësisht dakord/pëlqej).

Ne kemi si qëllim për të realizuar të paktën 400 pyetsorë për çdo shtet, duke respektuar përfaqësimin e barabartë gjinor dhe duke intervistuar banorë vendas mbi moshën 18-vjecare. Për këtë studim janë përzgjedhur të realizohen intervista të drejtpërdrejta. Pyetësorët në formë virtuale nuk u preferuan për shkak të aksesit të limituar të internetit në zonat rurale. Pyetësorët janë përkthyer në gjuhët përkatëse. Që prej prillit të vitit 2023, grupi i ekspertëve dhe vullnetarëve ka qenë në terren, duke realizuar intervista në të treja shtetet ku rrëqebulli i Ballkanit është i pranishëm. Kjo fazë e studimit pritet të përfundojë në dhjetor të vitit 2023. Pas kësaj ekspertët do të analizojnë të dhënat dhe rezultatet do të përfshihen në vlerësimin e fizibilitetit dhe analizën e rreziqeve, një dokument strategjik që do të ndihmojë në përforsimin gjenetik të popullatës së rrëqebullit të Ballkanit.

BLRP FESTON DITËN E RRËQEBULLIT

Nga Aleksandar Pavlov dhe Dime Melovski

Shoqata Ekologjike Maqedonase (MES), një nga organizatat partnere të programit, festoi ditën e rrëqebullit në Parkun Bunec Safari, në Mavrovë. Audiencia jonë ishin nxënësit e klasës së gjashtë nga shkolla fillore Kocho Racin, nga Kumanova, një shkollë jashtë zonës së rrëqebullit. Kjo zonë u zgjodh qëllimisht për ti dhënë një mundësi këtyre nxënësve për të mësuar për rrëqebullin e Ballkanit.

Një grup kurioz prej 30 nxënësish ndoqi një tur edukues përmes Bunec-it, aty ku stafi i Parkut Kombëtar të Mavrovës dhe përfaqësuesit e MES i udhëhoqën përmes botës magjike të jetës së egër, duke i paraqitur historinë e rrëqebullit të Ballkanit. Për entuziasmin tonë, fëmijët na bombarduan me një mori pyetjesh dhe ne ishim shumë të lumtur për t'ju përgjigjur. Ne gjithashtu imituam rrëqebullin duke lëvizur nëpër zonë, duke luajtur me një gjurmues aktiv të rrëqebullit. Detyra për grupin ishte që të gjenim ku fshiheshin vullnetarët me antenën dhe një radio. Ushtrimi perfekt për punën në terren! Në fund të turit nxënësit duhet të realizonin një detyrë praktike të eksploronin përreth zonës së tyre dhe të identifikonin llojet e bimëve dhe kafshëve, goftë përmes vrojtimit apo gjurmimit dhe shenjave. Kjo ishte për tu treguar atyre ndërlidhjen e jetës së egër dhe si gjithçka ndërlidhet në natyrë, por gjithashtu edhe se si parqet kombëtare janë zona me rëndësi të lartë për diversitetin.

Si pjesë e paketës edukuese, ne gjithashtu vendosëm të festonim Ditën e rrëqebullit me nxënësit e klasës së parë të shkollës fillore “Lazo Angelovski ” nga Shkupi, me të cilët kemi filluar dy kapitujt e parë të programit të edukimit. Rreth 150 nxënës vizituan Malin Vodno, afër kryeqytetit, për të gjetur pemën ideale për të vendosur një kamer kurth. Pas një ecje të këndshme në shteg, fëmijët ishin të lumtur të vendosnin kamerën dhe për t'a testuar duke imituar sjelljen e ariut, ujkut, rrëqebullit, lepurit apo dhe dhelpres, për tu fotografuar nga kamerat-kurth. Ata ishin të emocionuar kur panë më vonë fotografitë në kompjuter, ndërsa eksploronin modelin e kafkës së një rrëqebulli. Në përfundim, ne u ndamë në dy grupe dhe luajtëm kukamfshetas duke përdorur një antenë dhe një radio. Të lumtur me njohuritë që fituan, fëmijët më vonë shijuan një piknik të këndshëm, ku përveç ushqimit luajtën dhe lojërat e tyre të preferuara.



NJOHURITË TEKNIKE MBI MISHËNGRËNËSIT E MËDHENJ NË SLLOVENI TË PREZANTUARA PËRPARA PALËVE TË INTERESIT NË MAQËDONI

Nga Aleksandar Pavlov

Një vizitë studimore tre-ditore nuk mund të bëjë mrekulli, por sigurisht që mund të ofrojë një perspektivë tjetër për të gjithë që janë të gatshëm të përfitojnë nga kjo përvojë me vlerë! Në periudhën 24-26 maj, Shërbimi Pyjor Slloven mirëpriti një ekip me përfaqësues nga institucione Maqedonase të lidhura me ruajtjen e rrëqebullit të Ballkanit, duke ndarë njohuritë e tyre dhe duke prezantuar situatën aktuale mbi gjuetinë në vend, pyjeve dhe ruajtjes së natyrës. Kjo vizitë studimore u organizua nga Shoqata Ekologjike e Maqedonisë.

Me një program vizitor të shumëllojshëm dhe të plotë, pjesmarrësit nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Ekonomisë Ujore, Ndërmarrja Kombëtare Publike e Pyjeve dhe Parku Kombëtar i Mavrovës, patën një mundësi unike për të trajtuar një sërë temash- të gjitha të ndërthurura me çështjen e ruajtjes së rrëqebullit.

Dita e parë u fokusua në prezantimin e punëve të të gjithë pjesmarrësve në fushat përkatëse. Mikpritësit nga Sllovenia ofruan një pasqyrë të përgjithshme të punës dhe organizimit të Shërbimit Pyjor Slloven, menaxhimin e pyjeve dhe gjuetisë në Slloveni, por edhe zbatimin e projektit LIFE Lynx. Pjesmarrësit maqedonas treguan gjithashtu një pasqyrë të situatës aktuale në vend, duke ofruar prezantime dinamike rreth organizatës dhe situatës aktuale mbi institucionet e lartpërmendura.

Dita e dytë u organizua me vizita në terren. E nisëm ditën me vizitën tek Qendra e Mishëngrënësve të Mëdhenj Dina Pivka- një qendër kreative për bashkëpunimin ndërkufitar midis Sllovenisë dhe Kroacisë për ruajtjen mishngrënësve të mëdhenj dhe një vend për ndërgjegjësimin e publikut mbi rëndësinë e këtyre llojeve. Më pas u vazhdua me një vizitë në fshatin e qetë Juršče, ku një fermer i zonës ndau përvojën e tij në lidhje me parandalimin e dëmeve të mishëngrënësve të mëdhenj dhe përdorimin e qenve të stanit për ruajtjen e bagëtive, duke na dhënë një pasqyrë të jetesës së tij si bari.

Pas kësaj ishte Mašun-i, një shtëpi pylli që shërben si një muze i mishëngrënësve të mëdhenj. Aty u mirëpritëm nga Shoqata e Gjuetarëve Jelen, i cili shpjegoi situatën mbi gjuetinë në Slloveni dhe në rajon. Më pas, bëmë një vizitë edukuese ndërvepruese në shtegun e pyllit Mašun- një hapësirë edukimi kreative e ndërtuar në habitatin natyror të dominuar nga ahu.

E përmbyllëm ditën me një vizitë në kabinën Privat, një kasolle e vetmuar në pyll që shpesh vizitohet nga rrëqebulli dhe ariu, për tu kruajtur me pemët ose për të shënjuar territorin. Kjo kabinë përdoret nga kërkuesit e projektit LIFE Lynx, si një vend për vendosjen e kamerave kurth për të realizuar monitorimin e rrëqebullit.

Në ditën tonë të fundit të turit studimor vizituam Parkun Natyror të Triglavës, duke nisur nga zyra qendrore dhe një takim përshëndetës me drejtorin dhe disa rojtarë të pyjeve. Vazhduam në rrethimin e rrëqebullit në Pokjuka, ku pjesmarrësve iu shpjeguan metodat për lëshimin e ngadaltë dhe të shpejtë të rrëqebullit, si pjesë e aktiviteteve të projektit LIFE Lynx për përforcimin e popullatës së rrëqebullit. Vizita të tilla janë vërtetë të dobishme për palët më të rëndësishme të interesit, sepse marrin njohuri shumë të rëndësishme mbi aspektet më thelbësore të ruajtjes dhe mbrojtjes së natyrës. Vetëm nëpërmjet informimit të saktë dhe transparencës ne mund të shpresojmë të fitojmë mbështetjen e gjerë institucionale dhe angazhimin për të shpëtuar rrëqebullin e Ballkanit.



© MES/BLRP

PROPOZIM PËR PËRFSHIRJEN E RRËQEBULLIT EUROAZIATIK DHE RRËQEBULLIT TË BALLKANIT NË SHTOJCAT E KONVENTËS PËR LLOJET MIGRATORE (CMS)

Maqedonia e Veriut si propozues kryesor, Uzbekistani, Bosnja dhe Hercegovina dhe Shqipëria si bashkëpropozues kanë paraqitur një propozim për përfshirjen e rrëqebullit Euroaziatik (*Lynx lynx*) në Shtojcën II dhe rrëqebullin e Ballkanit (*Lynx lynx balcanicus*) në Shtojcën I të CMS, Konventa për Llojet Migratore:

https://www.cms.int/bukhara-deer/sites/default/files/document/cms_cop14_doc.31.4.1_listing-propozim-lynx-lynx_e.pdf

Vendimi do të merret në konferencën e 14-të të CMS, e cila do të organizohet në shkurt 2024 në Samarkand, Uzbekistan.



PROGRAMI PËR RIMËKËMBJEN E RRËQEBULLIT TË BALLKANIT

Balkan Lynx Recovery Programme (BLRP)

“Programi për Rimëkëmbjen e Rrëqebullit të Ballkanit” (BLRP) është një iniciativë e përbashkët që implementohet nga Fondacioni EuroNatur, KORA (Shoqata e Ekologjisë së Mishngrënësve dhe Menaxhimi i Jetës së Egër në Zvicër), MES (Shoqata Ekologjike Maqedonase), PPNEA (Qendra për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri) dhe ERA (Grupi i Veprimit me Përgjegjësi Mjedisore).

Informacion shtesë:
<https://www.facebook.com/balkanlynx>



Environmentally
Responsible
Action



PPNEA

PROTECTION AND PRESERVATION OF NATURAL ENVIRONMENT IN ALBANIA
• SINCE 1991 •



MACEDONIAN
ECOLOGICAL
SOCIETY



RAUBTIERÖKOLOGIE UND WILDTIERMANAGEMENT

eurolatur